Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë. së bashku me entitete që ata kontrollojnë. të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme . vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

#### 3.16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës se pozicionit financiar (veprimet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

## 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Manaxhimi i rrezikut financiar është një element i rëndësishëm në aktivitetin e Shoqërisë. Rreziqet kryesore me të cilat perballlet Shoqëria janë ato që lidhen me rrezikun e tregut, i cili përfshin rrezikun e çmimit, të normës së interesit dhe të kursit të këmbimit, rrezikun e kredise dhe rrezikun e likuiditetit.

### 4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Politikat e Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë, menaxhojnë rreziqet me të cilat perballlet Shoqëria, të përcaktojnë kufijtë e rrezikut, të vendosin kontrolle për të mbikëqyrur riskun në kufijtë e përcaktuar dhe të sigurojnë përmes monitorimit që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda ketyre kufijve. Politikat dhe procedurat për manaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe paraqitjen e praktikave të perditesuara.

Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim të ngushtë me mbikëqyrjen e strukturave të manaxhimit të riskut ka përgjegjësi të plote për mbikëqyrjen e kuadrit të manaxhimit të riskut, mbikëqyrjen e manaxhimit të rreziqeve kryesor dhe rishikimin e politikave dhe procedurave të tij të manaxhimit të rrezikut sikurse miratimin e transaksioneve të rëndësishme dhe me shumica të konsiderueshme.

Si faktorët e brendshëm ashtu edhe ato të jashtëm janë identifikuar dhe menaxhuar përmes strukturës organizative të shoqërisë dhe veçanërisht nga strukturat e manaxhimit të rrezikut në nivel grupi. Shoqëria mëmë e grupit ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin në tërësi të shoqërisë dhe atë të rrezikut në veçanti.

### 4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Rreziku i tregut vjen nga ekspozimi i kompanisë ndaj normave të interesit, kurseve të këmbimit dhe elementeve të tjera të cilat janë në ndikim të drejtperdrejtë të ndryshimeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e qëndrueshmërisë së çmimeve në treg.

Objektivi i manaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin e rrezikut të tregut brenda parametrevë të pranueshëm.

**Megapharma shpk****Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****4.2 Rreziku i tregut (vazhdim)**

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj në 31 Dhjetor 2022 është si më poshtë

	Euro	Usd	Lek	Total
<b>31 Dhjetor 2022</b>				
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	4,079,480	-	1,142,631,356	1,146,710,836
Parapagime te dhena	-	-	3,191,250	3,191,250
Mjete Monetare	25,910,897	2,960	64,792,608	90,706,465
	<b>29,990,377</b>	<b>2,960</b>	<b>1,210,615,214</b>	<b>1,240,608,551</b>
<b>31 Dhjetor 2022</b>				
Huamarrjet				-
Detyrime per qirane	10,048,727	-	-	10,048,727
Detyrime te pagueshme	1,746,354,282	199,417	94,319,070	1,840,872,768
Te tjera te pagueshme	-	-	104,902,999	104,902,999
	<b>1,756,403,008</b>	<b>199,417</b>	<b>199,222,068</b>	<b>1,955,824,494</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>(1,726,412,631)</b>	<b>(196,457)</b>	<b>1,011,393,145</b>	<b>(715,215,943)</b>
<b>31 Dhjetor 2021</b>				
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	3,811,570		829,245,757	833,057,326
Parapagime te dhena	26,773,649			26,773,649
Mjete Monetare	175,089,901	6,142	76,521,267	251,597,310
	<b>205,655,119</b>	<b>6,142</b>	<b>905,767,024</b>	<b>1,111,428,285</b>
<b>31 Dhjetor 2021</b>				
Huamarrjet				-
Detyrime per qirane	8,050,920			8,050,920
Detyrime te pagueshme	1,575,362,915	186,658	77,441,242	1,652,990,816
Te tjera te pagueshme			253,319,999	253,319,999
	<b>1,583,413,835</b>	<b>186,658</b>	<b>330,761,241</b>	<b>1,914,361,734</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>(1,377,758,715)</b>	<b>(180,516)</b>	<b>575,005,782</b>	<b>(802,933,449)</b>

**Analiza e ndryshimit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit**

Një ndryshim prej +/- 10% në kurset e këmbimit në monedhën EUR në datën e raportimit të pasqyrave financiare do kishte pakësuar fitimin e periudhës me 172,641,263 lekë (31 dhjetor 2021 137,775,871 lekë.)

Një ndryshim prej +/- 10% në kurset e këmbimit në monedhën USD në datën e raportimit të pasqyrave financiare do kishte pakësuar fitimin e periudhës me 19,645 lekë (31 dhjetor 2021 18,051 lekë.)



## 4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

## 4.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

Flukset monetare dhe rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit

Rreziku i normes së interesit është rreziku që ndryshimi në normat e interesit mund të shkaktojë luhatje në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e portofolit të investimeve.

Te ardhurat e Shoqërisë dhe flukset monetare operative janë pothuajse të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut pasi Shoqëria nuk ka aktive financiare të cilat mbartin interes. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë kryesisht huamarrjet dhe huadheniet me norma interesi të ndryshueshme, duke ndryshuar flukset e ardhshme monetare. Drejtimi i Shoqërisë nuk ka një politikë zyrtare të përcaktimit të shumave të dhena ose të marra hua me norma interesi fikse ose të ndryshueshme. Megjithatë, në kohën e huamarrjeve të reja drejtimi përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse një norme interesi fikse ose e ndryshueshme do të ishte më e favorshme për Shoqërinë gjatë periudhës deri në maturim.

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
<b>Aktive financiare</b>		
<i>Që nuk mbartin interes</i>		
Te drejta dhe të tjera të arketueshme	1,146,710,836	833,057,326
Mjete Monetare	90,706,465	251,597,310
<i>Me norma interesi fikse</i>	-	-
<b>Total aktive financiare</b>	<b>1,237,417,301</b>	<b>1,084,654,636</b>
<b>Detyrimet financiare</b>		
<i>Që nuk mbartin interes</i>		
Detyrime të pagueshme	1,840,872,768	1,652,990,816
Të tjera të pagueshme	104,902,999	253,319,999
	<b>1,945,775,767</b>	<b>1,906,310,814</b>
<i>Me norma interesi të ndryshueshme</i>		
Detyrime për qirane	10,048,727	8,050,920
	<b>10,048,727</b>	<b>8,050,920</b>



**4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****4.3 Rreziku i kreditit**

Rreziku i kredise eshte rreziku qe nje pale ne nje instrument financiar te shkaktoje nje humbje financiare ndaj pales tjeter duke deshtuar ne shlyerjen e detyrimit dhe vjen kryesisht si pasoje e llogarive te arketueshme te Shoqërisë nga klientet e saj.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është përfaqësuar nga vlerat kontabël të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përmbledhura si më poshtë:

	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	1,146,710,836	833,057,326
Mjete Monetare	90,706,465	251,597,310

Ekspozimi nga risku i kreditit per te drejta e arketushme te Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 është si më poshtë:

	<b>Totali i të arkëtueshmeve 31 Dhjetor 2022</b>	<b>Totali i të arkëtueshmeve 31 Dhjetor 2021</b>
Te pa maturuara		
30 dite pas afatit	908,931,692	702,235,740
Brënda 31-90 ditë pas afatit	10,287,260	8,835,428
Brënda 91-180 ditë pas afatit	241,938,500	130,344,336
Brënda 181-365 ditë pas afatit	-	-
365 ditë pas afatit	-	-
Zhvlerësimi	(14,446,616)	(8,358,178)
<b>Totali</b>	<b>1,146,710,836</b>	<b>833,057,326</b>

## 4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

## 4.4 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që Shoqëria të ndesh vështiresi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Përjasja e Shoqërisë për të manaxhuar likuiditetin është që të sigurojë aq sa është e mundur se do të ketë gjithmone likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj kur ato kërkojnë si në kushte normale dhe jonormale pa shkaktuar humbje të papranueshme ose të rrezikoje demtimin e emrit të Shoqërisë. Shoqëria sigurohet vazhdimisht se ka mjete të mjaftueshme monetare për të paguar shpenzimet e pritshme operationale, duke përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare. Kjo përjashton ndikimin e mundshëm të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen si psh. fatkeqesite natyrore. Si më poshtë janë paraqitur maturitetet e mbetura kontraktuale të detyrimeve financiare në datën e raportimit:

Më 31 Dhjetor 2022	Afatshkurta		Afatgjata			Totali
	1 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet		
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	1,149,902,086					1,149,902,086
Mjete Monetare	90,706,465					90,706,465
	<b>1,240,608,551</b>	-	-	-	-	<b>1,240,608,551</b>
Detyrime per qirane	3,497,095					3,497,095
Detyrime per qirane financiare	6,551,632					6,551,632
Detyrime te pagueshme	1,840,872,768					1,840,872,768
Te tjera te pagueshme	104,902,999					104,902,999
	<b>1,955,824,494</b>	-	-	-	-	<b>1,955,824,494</b>
<b>Risku i likuiditetit ne 31 Dhjetor 2022</b>	<b>(715,215,943)</b>	-	-	-	-	<b>(715,215,943)</b>

  

Më 31 Dhjetor 2021	Afatshkurta		Afatgjata			Totali
	1 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet		
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	859,830,975					859,830,975
Mjete Monetare	251,597,310					251,597,310
	<b>1,111,428,285</b>	-	-	-	-	<b>1,111,428,285</b>
Detyrime per qirane	3,513,217					3,513,217
Detyrime per qirane financiare	4,537,703					4,537,703
Detyrime te pagueshme	1,652,990,816					1,652,990,816
Te tjera te pagueshme	253,319,999					253,319,999
	<b>1,914,361,734</b>	-	-	-	-	<b>1,914,361,734</b>
<b>Risku i likuiditetit ne 31 Dhjetor 2021</b>	<b>(802,933,449)</b>	-	-	-	-	<b>(802,933,449)</b>



#### 4. Manaxhimi i rrezikut financiar

##### 4.5 Manaxhimi i riskut të kapitalit

Objektiva e Shoqërisë në lidhje me manaxhimin e kapitalit është ruajtja e aftësisë së saj për vijimesi të biznesit, në mënyrë që të mundësojë kthimin e përfitimeve të pritura nga aksionaret, e përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit e cila redukton koston e tij. Totali i kapitalit në administrim është i barabartë me kapitalin siç tregohet në bilancin kontabel plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si huamarrjet totale siç tregohet në bilancin kontabel minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Shoqëria nuk ka kërkesa rregullatore të vendosura nga jashtë në lidhje me kapitalin.

##### 4.6 Vlerësimi me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson vlerën me të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushtet e tregut. Vlera e drejtë është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e bazës së aktivitetit dhe të detyrimit.

##### Instrumentet financiare të prezantuar me vlerë të drejtë

Aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila i grupon aktivet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si vijon:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime financiare të ngjashme;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të disponueshme për aktivet dhe detyrimet e observuara direkt (p.sh. çmimet) ose indirekt (të dhëna nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhëna mbi aktivet dhe detyrimet që nuk janë të bazuar në të dhëna të disponueshme nga observimi i tregut

Tabela në vijim tregon një përmbledhje të vlerave kontabel neto dhe vlerave të drejta të atyre aktiveve financiare dhe detyrimeve që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë:

##### Te drejta dhe te tjera të arketueshme

Te drejta dhe te tjera të arketueshme janë mbajtur me kosto të amortizuara, minus provizionet për zhvlerësim. Vlera e tyre korrespondon me vlerën e tyre kontabel për shkak të maturitetit afatshkurtër.

##### Mjetet monetare

Vlera e drejtë e mjeteve monetare konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat respektive kontabel si pasojë e maturimit të tyre më të shkurtër se tre muaj.

##### Llogari dhe hua të pagueshme

Vlerat kontabel të llogarive të pagueshme dhe huave të pagueshme përafrohen me vlerën e tyre të drejtë.

Shenime	Vlera kontabel		Vlera e drejte	
		31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2022	
<b>Aktive Afatshkurtera</b>				
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	7	1,146,710,836	1,146,710,836	
Mjete Monetare	8	90,706,465	90,706,465	
<b>Detyrime Afatshkurtra</b>				
Detyrime per qirane	12	3,497,095	3,497,095	
Detyrime per qirane financiare	13	6,551,632	6,551,632	
Detyrime te pagueshme	14	1,840,872,768	1,840,872,768	
Te tjera te pagueshme	15	104,902,999	104,902,999	
<b>Detyrime Afatgjata</b>				
Detyrime per qirane	12	8,552,004	8,552,004	

## 5. Vleresimet dhe gjykimet e rëndësishme kontabel

Drejtimi i Shoqërisë ka përdorur gjykimin e tij në lidhje me një sërë vlerësimesh e supozimesh në lidhje me raportimin e aktiveve dhe detyrimeve dhe shpjegimin e aktiveve dhe detyrimeve të kushtezuara në përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SNRF. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vleresimet dhe supozimet e mëposhtme rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe ndryshimet njihen në periudhën në të cilën janë bërë vleresimet dhe në periudhat e ardhshme në të cilat këto vlerësime kanë ndikim.

### Pasiguria në gjykime

#### Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria rregullisht teston për zhvlerësim të arkëtueshmet e saj. Gjatë kryerjes së këtyre testeve shoqëria mer parasysh pagesat e rregullta të bera, pra debitori, pozicionin e tij financiar dhe operacionet, arketueshmerinë e pagesave nga instrumentat financiarë dhe një numër kriteresh të tjera të përdorura për të vlerësuar arketueshmerinë.

#### Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen me shumën më të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

#### Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr. 9. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.



## 6. Inventari

Inventari me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 paraqitet si mëposhte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Mallra per rishitje	896,703,264	827,565,474
<b>Total</b>	<b>896,703,264</b>	<b>827,565,474</b>

## 7. Te drejta dhe te tjera te arketueshme

Të drejta dhe të tjera të arkëtueshme me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si mëposhte vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Te drejta te arketueshme nga shfrytëzimi	908,931,692	702,235,740
Te drejta te tjera te arketueshme	252,225,760	139,179,764
Provizjon per zhvleresimin e te drejtave te arketueshme	(14,446,616)	(8,358,178)
<b>Total</b>	<b>1,146,710,836</b>	<b>833,057,326</b>

Levizja ne provigjonimin per zhvlerësimin e te drejtave te arketueshme eshte si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Provizjon per zhvleresimin e te drejtave te arketueshme me 1 Janar	8,358,178	4,804,249
Rimarrje provigjoni	-	-
Shpenzime provigjoni	6,088,438	3,553,929
Provizjon per zhvleresimin e te drejtave te arketueshme me 31 Dhjetor	<b>14,446,616</b>	<b>8,358,178</b>

7.a Te drejta te tjera te arketueshme perfaqeson garanci te ndryshme dhe te drejta te tjera te cilat paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
TVSH për tu marrë	5,482,916	4,073,275
Hua te dhena	241,938,500	130,344,336
Garanci te dhena	4,751,204	4,751,204
Te drejta ndaj autoriteti doganor	53,140	10,949
<b>Total</b>	<b>252,225,760</b>	<b>139,179,764</b>

7.b Parapagimet detajohen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Parapagime te dhena furnitoreve	3,191,250	26,773,649
Parapagime te dhena te tjera	-	-
<b>Total</b>	<b>3,191,250</b>	<b>26,773,649</b>

**Megapharma shpk****Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***8. Mjete Monetare**

Mjete Monetare janë paraqitur ne pasqyrat financiare me gjendjen e llogarive bankare ne fund te periudhes me date 31 Dhjetor 2022:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
<i>Mjete Monetare ne Banke</i>		
Vlera monetare bankare, në lekë	63,455,313	27,164,500
Vlera monetare, në monedha të huaja	25,913,857	175,076,043
<i>Mjete Monetare ne Arke</i>		
Vlera monetare ne arke	1,337,295	49,356,767
<b>Total</b>	<b>90,706,465</b>	<b>251,597,310</b>

**9. Aktivët Financiare**

Aktivët financiare perbehen nga investimi me pjesmarrje qe shoqeria ka tek shoqerite Orange Farmaci shpk dhe Megapharma KS shpk, si meposhte:

	% e pjesmarrjes ne kapital	Kapitali i nenshkruari	Investimi ne pjesmarrje ne 1 Janar 2022	vestimi ne pjesmarrje ne 31 Dhjetor 2022
Orange Farmaci shpk	75%	10,000 leke	7,500 Leke ( I zhvleresuar totalisht per shkak te humbjeve)	- Totalisht I zhvleresuar
MEGAPHARMA KS SH.P.K.	100%	10,000 Euro	5,880,068 leke	8,568,198



**10. Aktive Afatgjata Materiale**

Kosto Historike	Toka	Ndertesa	Makineri Pajisje	Mjete Transporti	Pajisje Informatike	Inventar Ekonomik	Totali
Gjendje 31.12.2021	52,425,000	102,115,126	34,000	72,666,267	9,601,561	14,663,673	251,505,627
Shtesa	-	-	-	8,855,477	1,866,732	472,420	11,194,629
Pakesime (-)	-	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2022	<b>52,425,000</b>	<b>102,115,126</b>	<b>34,000</b>	<b>81,521,744</b>	<b>11,468,293</b>	<b>15,136,093</b>	<b>262,700,256</b>
<b>Amortizimi</b>							
Gjendje 31.12.2021	-	9,956,225	32,448	40,524,060	7,245,093	9,449,515	67,207,341
Amortizimi i periudhes		4,607,945	311	6,667,444	507,110	1,057,722	12,840,532
Gjendje 31.12.2022		<b>14,564,170</b>	<b>32,758</b>	<b>47,191,504</b>	<b>7,752,203</b>	<b>10,507,237</b>	<b>80,047,872</b>
Vlera neto 31.12.2021	52,425,000	92,158,901	1,552	32,142,207	2,356,468	5,214,158	184,298,286
Vlera neto 31.12.2022	<b>52,425,000</b>	<b>87,550,956</b>	<b>1,242</b>	<b>34,330,240</b>	<b>3,716,090</b>	<b>4,628,855</b>	<b>182,652,383</b>

Shpenzimi i amortizimit i ngarkuar nga aktivet afatgjata materiale per vitin 2022 eshte 12,840,532 leke.

**Megapharma shpk**  
**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

**11. E drejta për te përdorur aktivet afatgjata materiale**

<i>Kosto Historike</i>	<i>Aktiv me te drejte perdorimi</i>
Gjendje 31.12.2020	8,341,557
Cregjistrimi I kontrates se vjeter	(8,341,557)
Njohja e kontrates se re per nje afat 5 vjecar	19,143,961
Gjendje 31.12.2021	19,143,961
Shtesa	-
Gjendje 31.12.2022	19,143,961
<i>Amortizimi</i>	
Gjendje 31.12.2020	7,232,053
Amortizimi per periudhen Janar-Mars 2021	1,109,504
Cregjistrimi I kontrates se qirase	(8,341,557)
Amortizimi per periudhen Prill-Dhjetor 2021	2,815,636
Gjendje 31.12.2021	2,815,635
Amortizimi 2022	3,551,177
Gjendje 31.12.2022	6,366,812
Vlera Neto	
Gjendje 31.12.2021	16,328,325
Gjendje 31.12.2022	12,777,149

Shpenzimi i amortizimit i ngarkuar për aktivin me te drejte perdorimi për vitin 2022 është 3,551,177 leke

**12. Detyrime për qiranë**

Shoqëria ka raportuar detyrimin e qirase në afatshkurter dhe afatgjate sipas maturimit të tyre.

	<i>31 Dhjetor 2022</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Pjesa afatshkurter e detyrimit	3,497,095	3,513,217
Pjesa afatgjate e detyrimit	8,551,990	13,110,966
<b>Total</b>	<b>12,049,084</b>	<b>16,624,183</b>



**Megapharma shpk**  
**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

**13. Detyrime per qirane financiare**

Detyrime per qirane financiare përfaqëson financimin nepermjet qirase financiare te mjeteve te transportit

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Detyrime per qirane financiare	6,551,632	4,537,703
<b>Total</b>	<b>6,551,632</b>	<b>4,537,703</b>

**14. Detyrime te pagueshme**

Detyrimet e pagueshme perfaqesojne balancat e papaguara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 si meposhte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Te pagueshme ndaj furnitorëve	1,823,485,868	1,636,845,702
Te pagueshme ndaj Punonjesve	13,335,993	7,675,389
Detyrime Tatimore	4,050,907	8,469,724
<b>Total</b>	<b>1,840,872,768</b>	<b>1,652,990,816</b>

a. Te pagueshme ndaj Punonjesve perfaqeson detyrimet ndaj punonjesve per tu paguar pas dates 31.12.2022:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Paga dhe shpërblime	11,708,747	6,183,230
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	1,627,246	1,492,159
<b>Total</b>	<b>13,335,993</b>	<b>7,675,389</b>

b. Detyrimet tatimore

Llogarite e detyrimeve fiskale paraqiten ne aktiv dhe ne pasiv te deklarimeve financiare. Ne pasiv te bilancit gjendja e detyrimeve te shoqerise kundrejt shtetit paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Tatim mbi te ardhurat nga punesimi	821,019	816,773
Tatimi mbi fitimin	3,175,240	5,060,951
Tatim ne Burim	54,648	2,592,000
<b>Total</b>	<b>4,050,907</b>	<b>8,469,724</b>

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit "Tatimi mbi te ardhurat" duke e pasqyruar tatimin mbi te ardhurat personale te rregjistruar drejt dhe te paguar me 31 Dhjetor 2022.

**15. Te tjera te pagueshme**

Shoqeria me 31 Dhjetor 2022, paraqetdividende per tu pagua ndaj aksionreve si meposhte;

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Dividende per t'u paguar	104,902,999	253,319,999
<b>Totali</b>	<b>104,902,999</b>	<b>253,319,999</b>

**Megapharma shpk****Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***16. Kapitali**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, është i njëjtë me atë të përcaktuar në ekstraktin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKB. Kapitali i regjistruar më 31.12.2022 është 120,000 Lek.

	<i>31 Dhjetor 2022</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Kapitali i nenshkurar	120,000	120,000
Rezerve Ligjore	1,730,820	1,730,820
Fitime e pashperndara	216,176,919	58,686,383
(Humbje) / Fitime te vitit financiar	158,905,307	157,490,535
<b>Totali</b>	<b>376,933,046</b>	<b>218,027,738</b>

**17. Te ardhura nga veprimtaria e shfrytezimit**

Shoqëria per periudhen nga 1 Janar 2022 ne 31 Dhjetor 2022 ka realizuar te ardhura nga shitje te mallrave si me poshte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
Shitje Mallrash	2,402,007,929	2,357,644,309
Te ardhura nga komisionet	50,789,916	24,215,763
<b>Totali</b>	<b>2,452,797,844</b>	<b>2,381,860,071</b>

**18. Te ardhura te tjera te shfrytezimit**

Shoqëria per periudhen nga nga 1 Janar 2022 ne 31 Dhjetor 2022 ka realizuar te ardhura si meposhte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
Qera	-	278,820
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>278,820</b>

**19. Mallra lende e pare dhe sherbime**

Shoqëria per periudhen nga 1 Janar 2022 ne 31 Dhjetor 2022 ka realizuar blerje te mallrave si me poshte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
Kosto e mallit te shitur	2,036,999,710	1,994,960,346
<b>Totali</b>	<b>2,036,999,710</b>	<b>1,994,960,346</b>



**Megapharma shpk****Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***20. Shpenzimet per personelin**

Ne kete ze perfshihen shpenzimet si meposhte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
Pagat dhe shpërblimet e personelit	89,198,957	82,704,791
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	11,298,478	10,161,075
<b>Total</b>	<b>100,497,435</b>	<b>92,865,866</b>

Numri mesatar i te punesuarve per vitin 2022 ishte 72 te punesuar (ne vitin 2021 numri mesatar i punonjesve ishte 70 te punesuar).

**21. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit**

Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si me poshte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
Blerje energji; avull; uje	2,424,222	1,764,713
Blerje te pastokueshme	18,511,017	12,678,765
Blerje/shpenzime te tjera	13,499,878	14,553,225
Qira	540,880	
Mirembajtje dhe riparime	5,673,231	6,242,988
Te tjera	23,499,608	10,939,108
Personel jashte njesise	18,101,304	14,673,148
Reklama; publicitet	15,714,835	15,407,899
Transferime; udhetim e dieta	4,603,413	11,141,901
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	2,359,164	2,404,349
Shpenzime per sherbime bankare	2,769,091	2,881,587
Taksa dhe tarifa vendore	775,544	-
Tatime te tjera	11,468,383	10,043,123
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	10,099,409	513,421
Gjoha dhe demshperblime	1,836,318	493,851
<b>Total</b>	<b>131,876,294</b>	<b>103,738,078</b>

**22. Shpenzime dhe te Ardhura financiare**

Ne kete ze perfshihen shpenzimet si me poshte :

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
Shpenzime për interesa	(2,270,078)	(1,013,615)
Te ardhura nga interesat	34,917	41,619
Fitim nga këmbimet valutore	42,113,487	18,789,118
Te ardhura te tjera financiare	291,565	-
Humbje nga kembimet valutore	(9,732,360)	(106,756)
<b>Total</b>	<b>30,437,531</b>	<b>17,710,365</b>

**Megapharma shpk****Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***23. Tatim fitimi**

Bazuar ne legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin eshte 15% per vitin 2022 (2021:15%). Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimore konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Kuadrimi i normes efektive te tatim fitimit per periudhen per qellime tatimore eshte si me poshte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
<b>Fitimi/Humbja bruto</b>	<b>190,288,342</b>	<b>186,059,698</b>
Shpenzime te panjohura	18,370,912	4,401,511
<b>Baza llog TF</b>	<b>208,659,254</b>	<b>190,461,209</b>
TF 15%	31,284,038	28,569,181
<b>Fitimi/ Humbja neto</b>	<b>158,905,307</b>	<b>157,490,535</b>

Shpenzimet e mëposhtme janë përjashtuar nga rezultati tatimor në referencë të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të ardhurat.

	<i>31 Dhjetor 2022</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Gjoha dhe dëmshpërblime	1,836,318	493,851
Shpenzime Transporti pa fature	120,800	-
Shpenzime pritje percjellje	8,536,324	-
Shpenzime per dieta udhetime	596,585	-
Shpenzime te tjera per zhvleresime dhe amortizim	6,088,438	3,553,929
Shpenzime shtese nga aplikimi I SNRF 16	-	237,546
Humbje nga investimi me pjesmarrje	1,192,447	116,186
<b>Totali</b>	<b>18,370,912</b>	<b>4,401,511</b>

**24. Transaksionet me palet e lidhura**

Transaksionet me palet e lidhura jane paraqitur me poshte:

	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</i>
<b>Shitje e mallrave</b>		
Shitje mallrash	314,288,625	158,494,742
<b>Totali</b>	<b>314,288,625</b>	<b>158,494,742</b>

<b>Llogarite e pozicionit financiar</b>	<i>31 Dhjetor 2022</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Hua dhene paleve te lidhura	234,528,769	127,298,769
Te drejta te arketueshme	404,916,676	314,288,625
Detyrime te pagueshme	-	-
<b>Totali</b>	<b>639,445,445</b>	<b>441,587,394</b>

Gjithe transaksionet kryhen ne kushte tregu (arm-length).



**Megapharma shpk****Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***25. Shenime te tjera**

Te përfshira ne Shenimin nr. 21 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytëzimit jane te përfshira tarifat e dhëna per shërbime auditimi dhe shërbime te dhënies siguri, ose shërbime te tjera keshillimore tatimore ose shërbime te tjera jo auditimi sa me poshte detajuar:

	Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2022	Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2021
<i>Per sherbime auditimi dhe sherbime te dhenies sigurise</i>		
Inter BBK Auditing shpk	600,000	750,000
<b>Totali</b>	<b>600,000</b>	<b>750,000</b>

Te përfshira ne Shenimin nr. 20 jane shpenzimet e personelit. Nje detajim i numrit mesatar te punonjësve te zëbërthyer sipas kategorive, eshte si vijon:

	Numri mesatar i punonjesve per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022	Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2022	Numri mesatar i punonjesve per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2021
<b>Pagat:</b>		<b>89,146,885.00</b>		<b>82,704,791.00</b>
Administratore	2	17,712,000.00	2	17,712,000.00
Departamenti Finances	2	813,000.00	2	813,000.00
Departamenti I Shitjeve	29	27,601,300.00	27	24,149,406.00
Departamenti Marketingut	33	34,530,200.00	32	31,540,000.00
Departamenti I Logjistikes	4	3,950,000.00	4	3,950,000.00
Departamenti I regjistrimeve	2	4,540,385.00	3	4,540,385.00
<b>Sigurimet</b>				
<b>shëndetësore e shoqërore:</b>		<b>11,251,549.00</b>		<b>10,161,075.00</b>
Administratore		473,664.00		473,664.00
Departamenti Finances		127,641.00		127,641.00
Departamenti I Shitjeve		3,946,985.90		3,465,524.89
Departamenti Marketingut		5,249,363.80		4,640,350.81
Departamenti I Logjistikes		695,650.00		695,650.00
Departamenti I regjistrimeve		758,244.30		758,244.30
<b>Total</b>	<b>72</b>	<b>100,398,434.00</b>	<b>70</b>	<b>92,865,866.00</b>

**26. Ngjarje pas datës se raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.